



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e parë të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: **31.01.2018** (e Mërkurë) duke filluar në ora **11:00**.

Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e K.K-së;
2. Plani mbajtjes së mbledhjeve;
3. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Formimi i Komitetit për Komunitete;
5. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 23.01.2018
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo-Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 12.01.2018, duke filluar në orën 11:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Anëtarët e Kuvendit, Kryetari i Komunës, Perfaqësuesit e OSBE-së, zyrtar komunal dhe qytetar të Komunës së Novobërdës.

Anëtari më i vjetër i Kuvendit Ramush Mehmeti pasi përshëndeti të pranishmit tha: materialin e keni pranuar me kohë për këtë mbledhje dhe besoj që pajtoheni me rendin e ditës që është percaktuar për këtë mbledhje.

Ramush Mehmeti tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet ta verifikoj kuorumin.

- 1.Nebojsa Arsic
- 2.Negovan Jovanovic
- 3.Predrag Stojkovic
- 4.Ivica Cenic
- 5.Mirjana Simijonovic
- 6.Jorgovanka Filic
- 7.Dragana Dimic
- 8.Selatin Nuhiu
- 9.Xhevat Mehmeti
- 10.Xhejlane Behluli
- 11.Abdyl Gashi
- 12.Ramush Mehmeti
- 13.Milica Jovanovic
- 14.Dobriboje Djordjevic
- 15.Bajrush Ymeri

Ramush Mehmeti tha: Kuorumi është në nivelin maksimal dhe mundë të fillojmë me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inaguruese K.K-së Novobërdë;
2. Dhënja e betimit të antarve të ri të Kuvendit Komunal të Novobërdës;
3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Novobërdës;
4. Konstatimi për zavendës kryesuesin e Kuvendit komunal të Novobërdës, simbas ligjit të Veqeverisjes lokale;
5. Të ndryshme;

Ramush Mehmeti i pyeti të pranishmit a janë për këtë rend dite.
Unanimishtë u aprovua rendi i ditës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inaguruese e Kuvendit të Komunës.
Ramush Mehmeti e hapi diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali u aprovua unanimishtë nga anëtarët e Kuvendit.

Pika e dytë: Dhënia e betimit të anëtarëve të rinjë të Kuvendit të Komunës së Novobërdës.
Në këtë seancë kemi një antarë të ri Selatin Nuhiu i cili është zvendësuar pasi që Fadil Gerbeshi ka dhënë dorëheqje dhe një anëtar tjetër Bajrush Ymeri i cili ka munguar në mbledhjen e kaluar për arsye shëndetsore.

Ramush Mehmeti i ftoi anëtarët e ri që ta japin betimin.

Bajrush Ymeri dhe Selatin Nuhiu e dhan betimin ku theksuan se do t'i kryenë me nder, besnikëri pa anime me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat ku do ta ushtron autorizimin e tij si anëtar i Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

Pika e tretë: Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Ramush Mehmeti tha: në baz të Ligjit për Vetqeverisje Lokale neni 41 Kuvendi Komunal e zgjedh Kryesuesin nga rradhët e antarëve të Kuvendit, në baz të ligjit duhet të ipen propozimet për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, dueht të jenë dy apo më tepër kandidat.

Ivica Cenik pasi përshëndeti të pranishmit tha: për Kryesues të Kuvendit të Komunës propozoj Nebojsa Arsic na partia LS.

Bajrush Ymeri pasi përshëndeti të pranishmit për Kryesues të Kuvendit propozoi Xhejlane Behluli.

Pasi nuk pati propozime tjera janë dy kandidatë për Kryesues të Kuvendit.

1. Nebojsa Arsic
2. Xhejlane Behluli

Ramush Mehmeti po ashtu theksoi se duhet të formohet komisioni verifikues prej 3 anëtarëve për verifikimin dhe numrimin e votave, duhet të ipen propozimet për këtë komision.

Bajrush Ymeri për anëtar të komisionit propozoi Xhevat Mehmeti.

Ivica Cenik për anëtar të komisionit propozoi Dobrivoje Djordjovic.

Xhevat Mehmeti për anëtar të komisionit propozoi Mirjana Simijonovic.

Pasi nuk pati diskutime tjera u formua komisioni prej 3 anëtarëve për verifikimin, votimin dhe numrimin e votave.

Anëtarët e komisionit janë:

1. Xhevat Mehmeti
2. Dobrivoje Djordjovic
3. Mirjana Simijonovic

Ramush Mehmeti tha: do ta bëjmë një pauzë prej 5 minutave deri sa të përgaditen fletvotimet.

Pas pauzes Ramush Mehmeti e pyeti komisionin se a jeni të gatshëm të fillojmë me votim?

Komisioni konstatoti se kanë pranuar 15 fletëvotime të vullosura dhe mund të fillojmë me votim.

Ramush Mehmeti tha: po i ftoj me radhë një nga një antarët që të votojnë.

Ramush Mehmeti tha: Procesi i votimit ka përfunduar kanë votuar të gjithë anëtarët e K.K-së, gjithsej 15 anëtar.

Në bazë të fletëvotimeve të votave nga 15 anëtar Nebojsa Arsic gjithsej ka marrë 12 vota ndërsa kundër kandidatja Xhejlane Behluli ka marrë 3vota.

Pasi nuk pati diskutime u prua ky:

V E N D I M

Nebojsa Arsic zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Novobërdës.

Ramush Mehmeti fjalën ja dha Kryesuesit Nebojsa Arsic.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Nebojsa Arsic pasi përshëndeti të pranishmit tha: Dua t'ju falënderoj që më keni votuar që të jem Kryesues i Kuvendit të Komunës së Novobërdës, shpersoj që besimin e juaj nuk do ta zhgënjej dhe gjithë së bashku mu ju ta përfaqsojmë këtë Kuvend, nese pajtoheni do të vazhdoj me pikën e katërt për zgjedhjen e zv.Kryesuesit.

Pika e katërt: Konstatimi për zavendës kryesuesin e Kuvendit komunal të Novobërdës, simbas ligjit të Veqeverisjes lokale;

Kryesuesi tha: Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nenit 54 në Komunitat që është komuniteti pakicë zgjedhet Zv.Kryesues ai që ka marrë më së shumti vota për anëtar të Kuvendit të Komunës, sipas informatave që i kamë marrë Zv.Kryesuesi i komunitetit i takon z.Bajrush Ymeri sepse ka marrë më së shumti vota dhe e ftoj që ta zërë vendin.

Pasi nuk pati diskutime tjera u prua ky:

V E N D I M

Bajrush Ymeri zgjedhet Zv.Kryesues i Kuvendit të komunitetit shqiptar.


Pika e pestë: Të ndryshme;

Kryesuesi e hapi diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Kryetari i Komunës Svetislav Ivanović pasi përshëndeti të pranishmit tha: në emrin tim personal dëshiroj t'ju uroj punë të mbarë të gjithë anëtarëve të Kuvendit të ciltë e kanë dhënë betimin dhe votat që i kemi marrë nga qytetarët, besimin e tyre që na kanë dhënë ta arsyetojmë në mënyrën më të mirë të mundshme,po ashtu Kryesuesit dhe Zv.Kryesuesit ju dëshiroj punë të suksesshme, të gjithë ne duhet punojmë që ta arsyetojmë besimin e qytetarëve të cilët na kanë dhënë votën e tyre në mandatin katër vjeçar ju faleminderit edhe njëherë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Valmire Mustafa
Procesëmbajtëse



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATE/A:	23.01.2018
PËR/ZA/TO:	Antarët e Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Nebojsa Arsic - Kryesues i Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2018

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2018.

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E mërkurë	31.01.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E mërkurë	28.02.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E enjte	29.03.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E hënë	30.04.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E enjte	31.05.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E mërkurë	27.06.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E martë	31.07.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E enjte	30.08.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
9.	E enjte	27.09.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
10.	E mërkurë	31.10.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
11.	E enjte	29.11.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal
12.	E enjte	27.12.2018	11:00	Salla e Kuvendit Komunal